

**VENDIM**  
**Nr. 14, datë 29.2.2012**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË SHNDËRRIMIT TË DEGËS SË BANKËS ALPHA -  
ALBANIA NË FILIAL/BANKË VENDASE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43 shkronja “e” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 29/1, nenit 29/2 dhe nenit 29/3 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shndërrimit të degës së “Bankës Alpha-Albania”, në filial/bankë vendase të zotëruar 100 % nga Alpha Bank A.E. Greqi.
  2. Miratimin e emrit të bankës “Banka Alpha Albania” sh.a.
  3. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për nënshkrimin e formatit të ri të licencës dhe aneksit të saj për “Banka Alpha Albania” sh.a., pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
  4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi, si dhe për verifikimin e plotësimit të kushteve të mëtejshme ligjore dhe/ose nënligjore nga banka.
  5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI**  
**Ardian Fullani**